



Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytëtarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry

RAPORTI MBI TË GJETURAT FAKTIKE

Keqpërdorimet përgjatë procedurave të prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë

Mos-implementimi i Memorandumit të Bashkëpunimit për Monitorim të Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë

Lëvizja FOL, pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me Ministrinë e Shëndetësisë me 10 qershor 2011, ka hasur në probleme dhe pengesa të vazhdueshme për implementimin e marrëveshjes së arritur për monitorimin e procedurave të prokurimit. Lëvizja FOL, për më shumë se tre muaj nga nënshkrimi i këtij memorandumi nuk është njoftuar për shumë procedura të prokurimit, nuk është lejuar monitorimi i procedurave të prokurimit, e gjithashtu, nuk kemi marrë përgjigje për kërkesën për qasje në dokumente zyrtare me numër 517 që është protokolluar në Departamentin e Administratës në këtë ministri.

Edhe pse Lëvizjes FOL, nuk i është lejuar monitorimi i procedurave të prokurimit në këtë ministri, ajo ka përgatitur dhe realizuar hulumtim investigativ për parregullsitë dhe keqpërdorimet që kanë ndodhur gjatë dhënies së tenderëve dhe realizimit të kontratave publike në këtë ministri.

Keq-menaxhimi i Depos së Barnave të Ministrisë së Shëndetësisë

Menaxhimi i depo së barnave bëhet nga kompania “Rimed”, e cila gjithashtu merr pjesë edhe në tender të tjerë, që paraqet konflikt të pastër interesi. Komentet e konkurrentëve të tjerë për menaxhimin e depos së barnave janë se “Rimed” ka konkurruar me 1/3 e shumës reale që duhen për menaxhimin e barnave. Njoftimet thonë se barnat nuk menaxhohen mirë nga kjo kompani. Dyshohet se së bashku me zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve tjera, bëjnë falsifikimin e dokumenteve për pranimin/dorëzimin e barnave, qoftë kur hyjnë në depo, apo edhe kur dalin nga depoja. Si pasojë e kësaj sasi të ndryshme të barnave nuk hyjnë fare në depo, shiten nga depoja, apo ndërrohen me barna që ju ka skaduar afati. Në bazë të dhënave të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në MSH, përlllogaritet se buxheti i Kosovës dëmtohet për çdo muaj rreth 40 mijë euro nga barnat pa afat¹. Sipas zyrtarëve nga Inspektorati Farmaceutik, barnat dhe materiali shpenzues, të cilat sigurohen nga Ministria e Shëndetësisë për nevoja të pacientëve të institucioneve publike të shëndetësisë jo rrallë kohëve të fundit janë gjetur nëpër barnatore dhe institucione private të shëndetësisë². E gjithë kjo bëhet me qëllim, *përfitimin material*.

¹ Zëri (2011). Çdo muaj 40 mijë euro barna pa afat. Prishtinë. <http://www.zeri.info/artikulli/2/8/32763/cdo-muaj-40-mije-euro-barna-pa-afat/>

² Ekonomisti (2011). Keqpërdoren barnat. Prishtinë. <http://www.ekonomisti.net/artikulli/27/0/20303/keqperdoren-barnat/>

Mos-licencimi i barnave dhe mos-cilësia e produkteve medicinale të ofruara në tender

Licencimi i barnave është një shqetësim tjetër dhe informatat që ka Lëvizja FOL, tregojnë se në shumicën e tenderëve operatorët prezantojnë barna të palicencuara apo edhe të licencuara brenda natës që ngjall dyshime për procedura korruptive të licencimit. Këtë e dëshmon edhe vendimi i OSHP-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit “Furnizim me Citostatikë-Ritender Lot 6”, për shkak të dyshimit se MSH ka kontraktuar kompani për furnizim me barna me cilësi të dyshimtë dhe të falsifikuara për pacientë me sëmundje të rënda të kancerit³.

Në bazë të hulumtimit të Lëvizjes FOL, cilësia e barnave që blihen nga Ministria e Shëndetësisë është e dyshimtë, si pasojë e problemeve të paraqitura më lartë. Dyshimet janë për barna të palicencuara apo edhe të falsifikuara. Shembulli më i keq është importi i barnave pa origjinë të kontrolluar që vijnë në Kosovë nga vende të ndryshme të botës dhe pakëtohen si produkte vendore.

Ministria e Shëndetësisë kontrakton kompaninë që drejtohet nga zyrtari i kësaj ministrie

Në njoftimin për dhënie të kontratës mbi tenderin “Furnizim me material medicinal”⁴, të publikuar më 28 janar 2011, është shpallur fitues kompania “Almakos Group”, ku person i autorizuar është Hajrullah Fejza, shef i Divizionit për Cilësi të Shërbimeve në Ministrinë e Shëndetësisë. Vlera e përgjithshme e këtij tenderi është 9 mijë e 720 euro ndërsa Ministria e Shëndetësisë ka përdorur si arsyetim çmimin më të lirë për të shpallur fitues këtë kompani. z. Fejza, dyshohet se është i përfshirë në shumicën e keqpërdorimeve në tenderët e MSH-së dhe njihet si “pazargjiu i tenderëve”. I njëjti është i akuzuar për vjedhjen e një aparati për operimin e perdeve të syve në vlerë prej mbi 100.000 euro⁵.

Ministria e Shëndetësisë vazhdon t’i shpërblejë me tenderë kompanitë që e furnizuan me barna pa afat

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në raportin e saj⁶, ka evidentuar se gjatë vitit 2010 në depot e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës gjenden barna me afat të skaduar në vlerë prej 519 mijë e 158 euro. Shënimet e Departamentit të Farmacisë tregojnë se kjo sasi e barnave është pranuar gjatë periudhës 2007-2009. Sipas këtij raporti, gjatë testimit të pagesave për furnizim me barna, kemi hasur se në faturat të cilat i kishte pranuar MSH, ishin të përfshira barnat me afat skadence më të shkurtër se një vit. Me kontratë parashihet që barnat të cilat i ofrohen MSH nga operatorët e kontraktuar, të kenë afat skadence minimum së paku një vit.

Kompanitë që kanë furnizuar Ministrinë e Shëndetësisë me këto barna janë “Agani”, “Santefarm”, “Medical Group”, “Liri Med”, “Exclusive” e “Novondirsk”. Ministria e Shëndetësisë ka vazhduar t’i

³ Koha Ditore (2011). Ministrinë e Shëndetësisë u pengua të blejë citostatikë “të falsifikuar”. Prishtinë. <http://www.kohaditore.com/index.php?page=1,3,68695>

⁴ Ministria e Shëndetësisë – Departamenti i Prokurimit (2011). Njoftim mbi dhënien e kontratës. Prishtinë. <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PIDcNotices&LIDc1&PCIDc-1&CitIDcVieëNotices&IDc40743>

⁵ Zëri (2011). MSH-ja shpërblen punonjësit e saj. Prishtinë. <http://zeri.info/artikulli/1/2/20286/msh-ja-shperblen-punonjesit-e-saj/>

⁶ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (2011). Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të ministrisë së shëndetësisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010. Prishtinë.

http://oag.rks-gov.net/Raportet%20shqip/2010/Ministrite/RaportiAuditimit_%20MSH_%202010_Shqip.pdf

shpërblejë me tenderë publikë këto kompani gjatë vitit 2011 edhe përkundër vërejtjeve të Auditorit të Përgjithshëm.

Në njoftimin për dhënien e kontratës nga Departamenti i Prokurimit në MSH, me 13 korrik 2011, për tenderin *"Furnizimi me barna dhe material hargjues për hemodializë - llot 15"*, fituese është shpallur kompania "Liri Med", me kontratë në vlerë prej 177 mijë euro⁷.

Në njoftimin për dhënien e kontratës nga Departamenti i Prokurimit në MSH, me 01 korrik 2011, për tenderin *"Furnizimi me barna dhe material hargjues për Hemodializë"*, fituese është shpallur kompania "Agani", me kontratë në vlerë prej 28 mijë euro⁸.

Në njoftimin për dhënien e kontratës nga Departamenti i Prokurimit në MSH, me 26 korrik 2011, për tenderin *"Furnizim me barna - llot 2"*, fituese është shpallur kompania "Novondirsk" nga Zvicra, me kontratë në vlerë prej 137 mijë e 624 euro⁹.

Në njoftimin për dhënien e kontratës nga Departamenti i Prokurimit në MSH, me 03 qershor 2011, për tenderin *"Furnizim me barna nga Lista Esenciale"*, fituese të disa lloteve janë shpallur disa nga kompanitë për të cilat Auditori i Përgjithshëm ka dhënë vërejtje sa i përket furnizimit me barna pa afat. Këto kompani janë: kompania "Agani", me kontratë në vlerë prej rreth 70 mijë euro; kompania "Liri Med", me kontratë në vlerë prej rreth 200 mijë euro. Gjithashtu fituese e disa lloteve brenda këtij tenderi është shpallur edhe kompania "Rimed", me kontratë në vlerë prej rreth 200 mijë euro, e cila kompani njëherësh menaxhon depon e barnave të MSH-së¹⁰.

Në njoftimin për dhënien e kontratës nga Departamenti i Prokurimit në MSH, me 31 mars 2011, për tenderin *"Furnizim me barna dhe material shpenzues nga Lista Esenciale"*, fituese të disa lloteve brenda këtij tenderi janë shpallur kompania "Santefarm", me kontratë në vlerë prej rreth 280 mijë euro; kompania "Agani" me kontratë në vlerë prej 7 mijë euro; kompania "Liri Med", me kontratë në vlerë prej rreth 40 mijë euro dhe kompania "Exclusive", me kontratë në vlerë prej rreth 10 mijë euro¹¹.

Në njoftimin për dhënien e kontratës nga Departamenti i Prokurimit në MSH, me për tenderin *"Furnizim me barna dhe material shpenzues nga Lista Esenciale- Llot 1,3,4,16,27,68,69"*, fituese të disa lloteve brenda këtij tenderi janë shpallur, kompania "Agani", me kontratë në vlerë prej rreth 15 mijë euro dhe kompania "Medical Group", me kontratë në vlerë prej 74 mijë euro.

⁷ Ministria e Shëndetësisë – Departamenti i Prokurimit (2011). Njoftim mbi dhënien e kontratës. Prishtinë. <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PIDcNotices&LIDc1&PCIDc-1&CtlIDcVieëNotices&IDc46652>

⁸ Ministria e Shëndetësisë – Departamenti i Prokurimit (2011). Njoftim mbi dhënien e kontratës. Prishtinë. <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PIDcNotices&LIDc1&PCIDc-1&CtlIDcVieëNotices&IDc46108>

⁹ Ministria e Shëndetësisë – Departamenti i Prokurimit (2011). Njoftim mbi dhënien e kontratës. Prishtinë. <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PIDcNotices&LIDc1&PCIDc-1&CtlIDcVieëNotices&IDc47259>

¹⁰ Ministria e Shëndetësisë – Departamenti i Prokurimit (2011). Njoftim mbi dhënien e kontratës. Prishtinë. <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PIDcNotices&LIDc1&PCIDc-1&CtlIDcVieëNotices&IDc44710>

¹¹ Ministria e Shëndetësisë – Departamenti i Prokurimit (2011). Njoftim mbi dhënien e kontratës. Prishtinë. <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PIDcNotices&LIDc1&PCIDc-1&CtlIDcVieëNotices&IDc42284>

Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Instituti për Shoqëri të Hapur dhe Mbrojtësit e të Drejtave Civile. Ky Raport është produkt i stafit të Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: ëëë.levizjafol.org

Rreth Lëvizjes FOL

Organizata është themeluar të mbështes qytetarin aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit. Për t'i përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndërmarrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.



Publikimi i këtij raporti është përkrahur nga OSI/CRD. Qëndrimet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë qëndrimet e OSI/CRD.